

## AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË “DIGITAL SEAMLESS” SH.P.K.

Sot më datë 1 Mars 2025, **Z. Erion Elmasllari**, i datëlindjes 06.04.1979 dhe **Z. Indrit Balili**, i datëlindjes 09.06.1990, shprehin vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “**Digital Seamless**” sh.p.k. si më poshtë vijon:

### 1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria “**Digital Seamless**” sh.p.k., nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si “shoqëria”, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

### 2. Ortakët themelues

Shoqëria është themeluar nga Ortakët:

- 1- Z. Erion Elmasllari
- 2- Z. Indrit Balili

### 3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**Digital Seamless**” sh.p.k. do të jetë:

Dizenjim software-i. Zhvillim dhe mirembajtje sistemesh software. Testim dhe permiresim software. Ndërtim dhe zhvillim sistemi (programi) për menaxhim të dhënash. Përgatitje programesh software për telefon, kompjuter dhe web. Krijim faqe interneti për subjekte të ndryshme vendase dhe të huaja.

Mirëmbajtje programesh kompjuterike dhe faqesh Interneti. Konsulencë në sistemet elektronike të përpunimit të të dhënave. Konsulencë informatike. Konsulencë dhe zhvillim shërbimesh dhe sistemesh të inteligjences artificiale. Import – eksport të pjesëve e paisjeve kompjuterike. Shërbime të lidhura me fushat e mesiperme si edhe çdo aktivitet tjetër që nuk ndalohet nga ligji.

### 4. Selia e shoqërisë

Selia e Shoqërisë “**Digital Seamless**” sh.p.k. do të jetë në: Rruga "Pjetër Bogdani", Ndërtesa Nr.10, Hyrja 5, Ap.Nr.29, Njesia Bashkiake Nr.5, Tiranë.

4.1 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

## 5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

## 6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare **“Digital Seamless” sh.p.k.** është 30.000 Lekë. (tridhjetë mijë)

Kapitali themeltar është nënshkruar respektivisht në tërësinë e tij nga Ortakët themelues si më poshtë vijon:

1. Z. Erion Elmasllari zotërues i 1 (një) pjese të kapitalit me vlerë 20.100 Lekë që përbën 67 % të kapitalit themeltar;
2. Z. Indrit Balili zotërues i 1 (një) pjese të kapitalit me vlerë 9.900 Lekë që përbën 33 % të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Asamblesë së Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.

## 7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë **“Digital Seamless” sh.p.k.** është **Z. Indrit Balili**.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare **“Digital Seamless” sh.p.k.** në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

## 8. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

Ortaku



*(Nënshkrimi)*

Erion Elmasllari

Ortaku



*(Nënshkrimi)*

Indrit Balili